




INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË PUBLIKE TË KOSOVËS



SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME INFLUENCË, COVID-19 DHE PATOGENËT TJERË RESPIRATORË NË KOSOVË, SEZONA 2025/2026 (JAVA 45-TË)

Simptomet e Gripit përfshijnë:

- Temperaturë/ethe
- Kokëdhimbje
- Lodhje
- Kollë e thatë
- Dhimbje fyti
- Rrjedhje hundësh
- Dhimbje muskulare
- Simptome gastrointestinale, si nauze dhe barkqitje




PËRMBLEDHJE

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike gjatë tërë vitit bën mbikëqyrjen permanente të Influcencës sezonale (ILI), ARI dhe SARI me intensifikim të aktiviteteve gjatë sezonës përkatëse. Mbikëqyrja realizohet përmes hulumtimit aktiv dhe pasiv në institucione shëndetësore dhe terren.

SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME INFLUENCËN SEZONALE NË KOSOVË, 2021/2022 - 2025/2026

Sipas grafikonit 1, ku janë paraqitur rastet e Influcencës sezonale (ILI) në 5 sezonat e fundit shohim se sezona 2025/2026 karakterizohet me numër më të ulët të rasteve të raportura, krahasuar me periudhën e njëjtë të sezonës 2024/2025 dhe fillim të aktivitetit nga java e 40-të e sezonës 2025/2026.

Grafikoni.1



SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME INFLUENCËN SEZONALE NË KOSOVË, 2025/2026 DHE PRAGU EPIDEMIK


Nga fillimi i sezonës, 29 shtator 2025 deri më 9 nëntor 2025 (java e 45-të) në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës janë raportuar 6,954 raste të Sëmundjes të ngjashme me Grip (ILI), 1,572 raste të Infeksioneve respiratore akute (ARI) dhe 9 raste me Infeksion të rëndë respirator akut (SARI).

Gjatë javës së 45-të (03.11.2025-09.11.2025) janë raportuar 1,240 raste ILI (Sëmundje e Ngjashme me Gripin), 250 raste ARI (Infeksion Respirator Akut) dhe 2 raste me SARI (Infeksion i Rëndë Akut Respirator).

Përmes sistemit të mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse dhe paralajmërimit të hershëm (SMSN) janë raportuar 284 raste ILI dhe 15 raste ARI.


Intensiteti i Influcencës sezonale sipas numrit të rasteve të raportuara për javën e 45-të paraqitet në aktivitetin e ulët të qarkullimit dhe krahasuar me javën e kaluar shënon rritje prej 3.76%. (Graf.2)


Grafikoni.2



Në grafikoni 3 shohim se në të gjitha komunat janë raportuar raste të dyshimta në Influcë dhe sipas numrit të rasteve të raportuara, numër më të lartë kanë komuna e Prishtinës, Prizrenit dhe Pejës ndërsa sipas Incidencës numër më të lartë të rasteve kanë komuna e Kamenicës dhe Pejës.


Grafikoni.3





Në raport me distribuimin e rasteve sipas grup-moshës dhe incidencës, nga numri total i rasteve të raportuara me ILI, shihet se të gjitha grup-moshat janë të atakuara derisa sipas Incidencës; grup-mosha 0-4 dhe mbi 65 vjeç. Sa i përket rasteve me ARI, grup-mosha më e atakuar është 0-4 vjeç (1,061 raste) pastaj grup-mosha 5-14 vjeç (211 raste), 15-64 vjeç (210 raste), dhe grup-mosha 65+ vjeç (90 raste). (Graf.4)

Grafikoni.4




MBIKËQYRJA VIROLOGJIKE

Në laboratorin e Qendrës Kombëtare të Influcencës – IKSHPK nga fillimi i sezonës 2025/2026 deri me 12 nëntor 2025, janë testuar gjithsej 857 mostra nga pacientët e qendrave sentinel dhe jo sentinel si raste të dyshimta në ILI, ARI dhe SARI. Nga mostrat e testuara 430 (50.17%) prej tyre të dyshimta në SARS-CoV-2 dhe 427 (49.82%) të dyshimta në Influcencë dhe patogjenët tjerë respiratorë. Gjatë kësaj periudhe në SARS-CoV-2 janë konfirmuar 16 raste (3.72%). Nga 427 mostrat e testuara në Influcencë dhe patogjenët tjerë respiratorë janë konfirmuar 5 raste me Influcencë A (pozitiviteti 1.17 %). Rastet e konfirmuara me Influcencë A janë nga komuna e Prishtinës (3 raste), Ferizaj (1 rast) dhe Viti (1 rast) dhe i takojnë grup-moshës 0-4 vjeç (2 raste), 5-14 vjeç (2 raste) dhe 35-50 (1 rast). Gjatë javës së katërdhjetë e pesë (03.11.2025-09.11.2025), nga labororet private janë raportuar gjithsej 35 mostra të testuara si të dyshimta në SARS-CoV-2. Nga këto mostra nuk është konfirmuar asnjë rast pozitiv. Nga patogjenët tjerë respiratorë, janë konfirmuar: 36 mostra me RSV, 100 mostra me Human Rhinovirus, 54 mostra me Human Adenovirus dhe 10 mostra me Parainfluenza Virus (Graf.5).


Rastet pozitive në RSV (8.43%), janë nga komuna e Prishtinës (19 raste), Fushë Kosovë (11 raste), Gjilan (2 raste) dhe me nga 1 rast komuna: Podujevë, Istog, Klinë dhe Obiliq. Rastet pozitive me RSV i takojnë grup-moshës 0-4 vjeç (32 raste), 5-14 (2 raste), 35-50 (1 rast) dhe 65+ (1 rast) (Graf.5).

Grafikoni.5



Sipas subtipit: me subtipin AH3 është konfirmuar një rast apo 33%, me subtipin AH1N1 janë konfirmuar 2 raste apo 67% dhe me Influcencë A të pa subtipizuar janë konfirmuar 2 raste apo 40%. (Graf.6.)

Grafikoni. 6



AKTIVITETET SEZONALE

IKSHPK/Departamenti i Epidemiologjisë bënë mbikëqyrjen e Influcencës gjatë tërë vitit, me intensifikim të saj gjatë sezonës përkatëse (java e 40 deri në javën e 20).

Përcjell situatën epidemiologjike me rastet ILI/ARI (javore) dhe rastet me SARI (në bazë ditore/alerti).

Bënë testimin laboratorik të mostrave në Departamentin e Mikrobiologjisë/Qendrën Kombëtare për Testimin e Influcencës.

Ka dhënë këshilla për popullatën për mbrojtjen nga sëmundja dhe njohjen e simptomeve të saj.

VAKSINIMI

Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me IKSHPK në fillim të sezonës së gripit 2025/2026 ka siguruar 85,000 doza të vaksinës sezonale) dhe me fillimin e sezonës ka filluar vaksinimi sipas rekomandimeve. Deri më 15 tetor janë administruar gjithsej 40,845 doza të vaksinës kundër gripit sezonal.

MASAT PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË VIRUSIT TË GRIPIT SEZONAL

Aktiviteti i gripit për sezonën 2025/2026, është në nivel më të lartë krahasuar me sezonën paraprake dhe masat për parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve respiratore janë:

Mbajtja e maskave.

Distanca fizike.

Higjiena e duarve.

Evitimi i kontakteve të afërta me individë të sëmurë.

Redukimi i vizitave të familjarëve tek personat e hospitalizuar (SHSKUK, Spitalet rajonale).

Evitimi i vendeve të mbyllura dhe të mbingarkuara me njerëz.

Ushqimi i shëndetshëm me shumë vitamina.

Aktiviteti fizik dhe gjumë i mjaftueshëm.

Personat e sëmurë të qëndrojnë në shtëpi.

- Pastrimi dhe dezinfektimi i mjediseve ku qëndroni.
- Mbulimi i hundës dhe gojës me një shami gjatë teshtitjes dhe kollitjes si dhe hudhja më pas në vend të sigurt.
- Larja e duarve shpesh me ujë dhe sapun, ose solucione duarsh me alkool.
- Sytë, hunda dhe goja të mos preket me duar të kontaminuar, pasi virusi përhapet në këtë mënyrë.
- Pastrimi dhe dezinfektimi i sipërfaqeve dhe objekteve që mund të jenë kontaminuar nga virusi.

Konsultimi me mjekun për mjekimin me barna kundër gripit, të cilat duhet të merren vetëm me rekomandimin e mjekut

Medikamentet kundër gripit duhet të fillohen brenda 48 orëve të para të fillimit të sëmundjes për të pasur efektivitet të lartë.

Ato mund të parandalojnë edhe komplikimet e rënda që mund të vijnë nga gripit.

Mënyra më efikase për parandalimin e virusit të gripit është Vaksinimi me vaksinën kundër gripit.

- Vaksinimi mbron vetë personin dhe ndihmon në parandalimin e përhapjes së gripit.
- Efekti i vaksinës fillon 1 deri 2 javë pas marrjes dhe mbrojtja vazhdon rreth një vit pas vaksinimit.

HOSPITALIZIMET

Gjatë javës së fundit nga rastet e hospitalizuara në Klinikën Infektive, Klinikën e Pediatriisë dhe spitalet rajonale janë raportuar 31 raste me ARI, 1 rast me ILI dhe 2 raste SARI.

SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE NË RAJON DHE EVROPË

INFLUENCA SEZONALE JAVA 45/2025 NË EVROPË

Aktiviteti i sëmundjeve të ngjashme me gripin (ILI) dhe infeksioneve akute respiratore (ARI) është rritur mbi nivelet bazë në 2 nga 30 vendet dhe zonat e Rajonit European të OBSH-së që raportuan këtë javë. Në nivel rajonal, aktiviteti i gripit mbetet nën pragun sezonal, por treguesit vazhdojnë të shënojnë rritje nga nivele ende të ulëta, sidomos në kujdesin parësor, ku përqindja e mostrave pozitive është më e larta për këtë periudhë që nga viti 2022. Pothuajse të gjitha detektimet e virusit të gripit kanë qenë të tipit A, shumica e të cilëve janë nën-tipe A(H3). Hospitalizimet dhe vdekjet për shkak të gripit mbeten të pakta, megjithëse disa vende po raportojnë rritje më të theksuara të aktivitetit të gripit. Aktiviteti i SARS-CoV-2 po tregon rënie në shumicën e vendeve, por mbetet i lartë në disa zona; varianti XFG vijon të dominojë në rajon. Aktiviteti i RSV po rritet mbi nivelet ndërsezonale, megjithëse ende mbetet i ulët. Në nivel rajonal, 1 vend (Kazakistani) raportoi rritje të ILI mbi nivelin bazë dhe 1 vend tjetër (Gjermania) raportoi rritje të ARI. Përqindja e mostrave pozitive për grip nga qendrat sentinel ishte 7% (krahasuar me 6% javën e kaluar), nën pragun epidemik prej 10%. Pozitiviteti për SARS-CoV-2 ra në 7% nga 10% javën e kaluar, ndërsa për RSV mbeti në 1%. Nga 175 mostra me tip të njohur gripi, 99% ishin viruse të tipit A, me 70% A(H3) dhe 30% A(H1)pdm09. Asnjë vend nuk raportoi intensitet të mesëm ose të lartë të aktivitetit të gripit, ndërsa 6 vende raportuan përhapje rajonale ose të gjerë (Kazakistani, Norvegjia, Spanja, Turqia, Ukraina dhe Irlanda e Veriut). Nga mostrat e rasteve me SARI, 5% rezultuan pozitive për virusin e gripit (të gjitha tip A), 8% për SARS-CoV-2 dhe 2% për RSV. Vetëm një vend (Mbretëria e Bashkuar – Anglia) raportoi rritje të shtrimeve në ICU për shkak të gripit. Vdekjet nga COVID-19 mbeten të ulëta në 41 vendet që raportuan të dhëna. Nga analizat laboratorike të viruseve të gripit që qarkullojnë që prej javës 40/2025, dominon nën-tipi A(H3). Nga 63 viruse të karakterizuara, 73% ishin A(H3), 24% A(H1)pdm09 dhe 3% të linjës B/Victoria. OBSH rekomandon që vaksinat trivalente për sezonin 2025/2026 në hemisferën veriore të përmbajnë përbërësit përkatës të tipave A(H1N1)pdm09, A(H3N2) dhe B/Victoria. Sa i përket SARS-CoV-2, në javët 42–43/2025, varianti XFG përbënte mesatarisht 81% të sekuencave të raportuara në 6 vende, ndjekur nga NB.1.8.1 (12%) dhe BA.2.86 (3%, duke përfshirë nën-variantin JN.1). Në bazën e të dhënave GISAID për tetorin, variantet më të zakonshme në Rajonin European ishin XFG (48%), XFG.3 (22%), NB.1.8.1 (9%) dhe XFG.3.4.1 (5%).

Burimi: <https://erviss.org/>